


## Çka është mësimi i profesionit? Tri vende mësimi



**Ecole professionnelle:** Shkolla e degës së profesionit  
**Entreprises formatrice:** Ndërmarrja për aftësim profesional  
**Centre de cours interentreprises:** Qendra e kursit

**Formation scolaire:** Arsimimi shkollorë  
**Formation à la pratique professionnelle :** Shkollimi në ndërmarrje  
**Techniques fondamentales:** Diturive dhe shkathtësive praktike

Shkollimi themelorë apo bazë i profesionit (i quajtur edhe shkollim profesional apo zanat) është shkollim më i përhapur në mesin e të rinjve në Zvicër. Është një përzierje e shkollimit profesional teorik dhe praktik dhe përfundon me një diplomë, e cila është e njohur dhe e vlerësuar lartë në mbarë Zvicrën. Diplomimi njihet me këta emra:

- Pas një shkollimi 2-vjeçar: AFP (Atestim Federal i Profesionit)
- Pas një shkollimi 3- ose 4-vjeçar: CFAP (Certifikata Federale e Aftësimit Profesional)

Nëse ju për shembull ndiqni një Shkollim Profesional me Certifikatë Federale të Aftësimit Profesional, mësoni në tri vende mësimi:

### **1. Ndërmarrja për aftësim profesional (ndërmarrje tregtie, shtëpi mallrash, spital, ndërmarrje ndërtimi, restorant, garazh automobilash dhe shumë të tjera)**

Në ndërmarrjen për mësimin e profesionit punoni bashkë me të tjerët punë të përditshmërisë. Në fillim do të keni detyra më të lehta, dhe me vazhdimin e shkollimit edhe detyra më të sofistikuara. Njëkohësisht mësoni në mënyrë praktike ato që duhen ditur në profesionin përkatës (Operacione manuale, puna me vegla dhe makina, shërbimi ndaj klientëve etj.). Gjatë kësaj do të keni mbështetje dhe përkrahje të veçantë nga mësuesi apo mësuesja juaj i/e profesionit dhe personave tjerë përkujdesje (bashkëpunëtorë, nxënësit tjerë të cilët mësojnë profesionin me Certifikatë Federale të Profesionit dhe janë më përpara).

Në ndërmarrje i kaloni 3-4 ditë në javë, për shembull prej të hënës deri të mërkurën dhe të premten. Pasi që ju-prej fillimit dhe me kalimin e kohës së mësimit të profesionit- jeni produktiv në ndërmarrjen ku mësoni profesionin, merrni një rrogë për shëgertë. Lartësia e rrogës dallon nga profesioni dhe viti i shkollimit në profesion- mes 400,- dhe 1600,- franga në muaj. Ju keni të drejtë për 5 javë pushim vjetor.

### **2. Kurse jashtë ndërmarrjes**

Ndërmarrjet, të cilat prodhojnë prodhime të ngjashme apo ofrojnë shërbime të ngjashme, kanë teknika dhe metoda të ngjashme të punës. Secili profesion kërkon një komplet të caktuar të diturive dhe shkathtësive praktike. Këto shkathtësi mund t'i mësoni, përveç në ndërmarrje, ashtu edhe në kurse jashtë ndërmarrjes. Kurset jashtë ndërmarrjes mund t'i ndiqni në formë njëditore apo në disa ditë gjatë vitit. Zakonisht në një qendër regjionale të kurseve; kurset jashtë ndërmarrjes për ju janë falas.

### **3. Shkolla e degës së profesionit**

Në shkollën e degës së profesionit, mësoni një deri dy ditë në javë (8-15 orë) njohuritë teorike në që i përkasin profesionit tuaj dhe zgjeroni njohuritë tuaja në lëndët themelore si gjuhët, njohuritë e përgjithshme (politikë, drejtësi, shkencë politike, kulturë, teknikë, ekonomi, financa dhe konsumi, marrëdhëniet dhe bashkëjetesa, sigurimet dhe shumë të tjera). Mësimi mbahet zakonisht në shkolla të regjionit tuaj dhe janë falas (kontribute për mjetet mësimore), ekskursione dhe të ngjashme janë gjithashtu të mundshme).

Përveç kësaj, ju mund të ndiqni mësimin profesional në klasa të veçanta, të pajisura enkas për këtë (punëtori, laborator, dhomat e kompjuterëve dhe të tjera). Në këto mësim të orientuara kah praktika e mësoni pjesën profesionale të shkollimit tuaj profesional. Në shkollën e degës së profesionit keni edhe detyra shtëpie dhe duhet të përsëritni mësimin në kohën e lirë.

Përveç kësaj përgatiteni edhe për provimet, në të cilat merrni nota; notat vlejné për diplomimin tuaj profesional.

Kush nuk mundet t'i ndjekë sa duhet mësimet në shkollën e degës së profesionit, dhe në provime merr nota të pamjaftueshme, ka të drejtë në kurse shtytëse.